



	REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E KAÇANIKUT OPŠTINA KAÇANIK	
Data Hj. org.	24.10.18 01	Vendi Numri Shtojcë 105/02-36787



Republika e Kosovës

Komuna e Kaçanikut

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSB)-

01.Nr. zyrtar/ 2018

Procesverbal

Takimi i IV-të i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2018

Më 20.08.2018

Në takim prezantuan:

Besim Ilazi, Kryetar i Komunës

Afrim Halili, Komandant i Policisë-Kaçanik

Ali Vishi, përfaqësues i FSK-së

Kjani Sallahu, (mediet, OJQ-të, zejtarët, PAK-të)

Fatmir Qaka, EVSB

Ramadush Osmani-Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencia

Zahir Doda- Drejtor i DAK

Vedat Dema- Zyra për Barazi Xhinore

Lirije Luta-Komiteti për Komunitete

Menduh Rexha-Bashkësia Islame

Shemsedin Abazi-(KLSP)

Prezent ishin edhe Beqir Krasniqi nga Qendra për Punë Sociale dhe Zekirja Baftiu nga SH.M.P „Vellezërit Qaka , Feriz Guri”, ndërsa munguan Fadil Guri dhe Jashar Selimi

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës së Kaçanikut z.Besim Ilazi dhe propozoi këtë rend dite:

- 1.Miratimi i procesverbalit nga takimi i kaluar
- 2.Gjendja e sigurisë në Komunën e Kaçanikut
- 3.Diskutim rrëth dukurive negative në shoqëri , sidomos nëpër shkolla
- 4.Menagjimi i mbeturinave në komunën e Kacanikut
- 5.Diskutim rrëth ankesave të qytetarëve që ndërlidhen me sigurinë e përgjithshme në komunën tonë
- 5.Të ndryshme

1. Miratimi i procesverbalit nga takimi i kaluar

- Procesverbal u miratua nga të pranishmit

2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Kaçanikut

-Reth kësaj pike raportoi **Komandanti i Policisë** i cili dha një raport të detajuar për periudhën në mes dy takimeve dhe tha se edhe pse kjo periudhë ka pasur ngarkesë prej fluksit të njerëzve dhe automjeteve , në përgjithsi ka qenë situatë e qetë , stabile dhe nuk ka indikacione për ndonjë situatë që mundë të prishë rendin dhe qetësinë publike.Kemi ndërhy në gjashtë raste ku ka pasur të shtëna me armë zjarri nëpër darsma me qka bëjmë apel që kjo dukuri të eliminohet një hërë e përgjithmonë.Me zjarre nuk kemi pasur asnjë rast , nëpër pishina gjithqka ka shkuar si duhet e sa i përket aksidenteve ne kemi planin operativ në kuadër të TASK FORCËS me qka ka ndikuar në uljen e aksidenteve.Në kuadër të këtij plani kemi bërë edhe shpërndarje të broshurave tek qytetarët për kujdesin e tyre gjatë vozitjes.Problematika e vjedhjeve në kompaninë Bechtelenka vazhdon ende por që ne kemi marrë masa duke zbuluar disa raste të vjedhjeve por që mendoj që kjo dukuri është kalimtare pasi që punimeve të autostradës po i vie fundi.Aktiviteti STOP DROGAVE NËPËR SHKOLLA ka rezultuar i suksesshëm dhe mendojmë që kët aktivitet ta vazhdojmë edhe në të ardhmën.Kemi pasur një rast të zjarrvënjes me qëllim në një kompani në fshatin Shtrazë dhe ne jemi duke u marrë me kët rast.

-Kryetari: Falënderojmë Komandantin për kët informacion njëherit vlersojmë punën e policisë që kanë bërë në kët periudhë që ka qenë e stërvgarkuar.

Kjani Sallahu: Është për t'u pëershendetur lirimi i hapësirës publike përballë hyrjes në xhaminë e qytetit, një problem i artikuluar shpeshherë nga ne në mbledhjet e KKSBB-së. Po bëhet një punë e mirë, e cila i jep mundësinë zgjerimit të rrugës dhe ndërtimit të trotuarit për lëvizje të lirë të qytetarëve, por të mos shndërrohet si destinim për parkimin e automjeteve.

Përndryshe, sot kisha me i paraqitë në pikë të shkurta disa problematika që janë shqetësim i madh për qytetarët, duke filluar me qarkullimin e automjeteve me persona pa patentshoferë, ku në mesin e tyre ka edhe fëmijë, pastaj shitësit ambulant nëpër rrugë veq po shtohen sipas sezonave dhe në hapësira publike që rrezikojnë qytetarët; dëmitimi i aksit rrugor magjistrale – Gajre, si pasojë e shirave dhe punimeve të autostradës; Përroi i lagjës Kovaqi paraqet rrezik nga vërshimet; cilësia e bukës jo e mirë, produktet ushqimore me afat të skaduar, perimet që vijnë nga jashtë jo të kualitetit të mirë, prerja e pyjeve po vazhdon, etj. Pra, këto janë disa problematika që po na përcjellin vazhdimisht e që duhet ndërmarrë masa që ti evitojmë.

Shemsedin Abazi : është shtuar dukuria e lypsarëve nëpër rrugë ku kryesisht janë persona që vijnë nga Shqipëria dhe është një shqetsim se edhe mundë të kidnapojnë fëmijë ngase ky grup është i organizuar dhe mundë të na sjellin probleme në të ardhmën

Komandanti i Policisë: sa i përket asaj se ky grup mundë të bëjë kidnapime të fëmijëve deri më tanë nuk kemi pasur asnjë rast në tër Kosovën por që kujdesë duhet pasur dhe të lajmërohet qdo rast i dyshimitë.

Kryetari: sa i përket shitësve ambulant ne disa herë kemi intervenuar por që kemi të bëjmë me kategori të shtresës sociale dhe nuk po mundemi ti largojmë me forma të dhunshme. Në lagjën Kovaq kemi marrë masa dhe gjendja do të sanohet por jo vetëm në kët përrua por në të gjithë përenjët që mundë të shkaktojnë probleme. Për rrugën e fshatit Gajre ne kemi bërë marrëveshje gojore me Ministrinë e Infrastrukturës që do të intervenohet. Sa i përket produkteve ushqimore me afat të skaduar, inspektorët i kemi në teren dhe kemi pasur raste që i kemi konfiskuar disa produkte. Është shqetsuese prerja e pyjeve sidomos në pjesën e parkut nacional por që është detyrë e nivelit qendrorë të mirret me kët qështje.

Kjanni Sallahu: Ekziston një vendim i KK të Kaçanikut, sipas të cilit nuk lejohen ndërtime më afér se 10 metra afér rrugës në aksin Kaçanik-Doganaj. Por, faktikisht, në këtë pjesë janë duke u realizuar ndërtime që janë shumë afér rrugës. Pse po i lejon Komuna këto ndërtime, ose pse nuk po i pengon? Përderisa në qytet nuk mund t'i rrënojmë muret dhe shtëpitë, ndërtime të trashëguara nga lëshimet e paraardhësve, pse nuk po mësojmë nga pësimet, por po vazhdojmë me të njejtat gabime. Rruga Kaçanik-Doganaj ka gjatësi 9 kilometra dhe e ardhmja do të kërkojë rrugë më të gjerë, me më shumë korzi, me trotuare, etj. Të ndalet ky trend sa më shpejtë.

Kryetari: Për kët qështje Drejtoria përkatëse ka kriteret dhe mundë të reagojë aty ku këto kritere nuk përputhen.

Beqir Krasniqi: Shqetësim për qytetarët është prezenca e bagëtive nëpër rrugë e trotuare të cilët po i dëmtojnë drunjët dekorativ dhe po paraqesin pengesa në komunikacion. Më intereson të dijë se a është marrë ndonjë masë ndonjëherë.

Kryetari: Është vërtetë shqetësuese kjo dukuri por që për marrjen e masave në parandalimin e kësaj dukurie nevoitet një kosto e madhe bugjetore.

Menduh Rexha: Më intereson të dijë për hapsirën publike para xhamisë ku janë zhvendosur dy varre, qka do të punohet në kët hapsirë dhe a ka ndonjë afat kohorë ngase ashtu siq është mendoj që nuk është mirë të mbetet kohë të gjatë.

Ramadush Osmani: Posa të dislokohet shtylla elektrike në kët pjesë nga kompania KEDC, ne do të fillojmë ndërtimin e trotuarit me kubza betoni.

Komandanti i Policisë: Hapsira për parkingje të automjeteve është e pamjaftueshme dhe mundësish të hulumtohet ndonjë vend sidomos në rrugën „Qamil Ilazi” dhe „Idriz Seferi” që sadopak kjo problematikë të zgjidhet

3. Diskutim rreth dukurive negative në shoqëri , sidomos nëpër shkolla

-Rreth kësaj pike fjalën mori Drejtori për Arsim e Kulturë **Zahir Doda** i cili tha se projekt i përbashkët me Policinë e Kosovës rreth sigurisë së nxënësve nëpër shkolla vitin e kaluar ka rezoltuar i efektshëm dhe mendoj që projekte të tillë duhet të vazhdohet edhe në të ardhmën me qka do e përkrahim qdo iniciativë të tillë.Përdorimi dhe shpërndarja e drogave nëpër shkolla nuk është edhe aq alarmante sa flitet.Ne si drejtori kemi përpiluar një rregullore rreth sigurisë së fëmijëve nëpër shkolla me qka kërkoj edhe ndihmën e Qendrës për Punë Sociale dhe prindërve në mënyrë që të sjellim siguri për fëmijët.

Zekirja Baftiu : SH.M.P „Vellezërit Qaka” , „Feriz Guri”ballafaqohet me probleme të mëdha sa i përket qështjes së sigurisë së nxënësve duke filluar me mungesë të shenjëzimit të rrugës që të qon në drejtim të kësaj shkolle , probleme ka shkaktuar edhe zhvendosja e tregut të gjelbërt që po pengon qarkullimin e lirshëm në trotuaret e kësaj pjese të rrugës , prania e personave që nuk janë nxënës në hapsirën e jashtmë të shkollës si dhe një problematikë e kahmotshme i mos përfundimit të aneksit të shkollës.

Kryetari: Shenjëzimi i rrugës në kët pjesë është punë që mundë të bëhet dhe që do të angazhohemi në kët drejtim , e sa i përket tregut të gjelbërt që është vendosë në kët pjesë për momentin do të mbetet kështu deri në kohën kur të bëjmë një zgjidhje të përhershme.Sa i përket gravitimit të personave që nuk janë nxënës nëpër oborrin e shkollës është përgjegjësi e shkollës të mirret me kët punë . Nga viti i ardhshëm do të filloj ndërtimi i pjesës së aneksit të mbetur të kësaj shkolle.

Kjani Sallahu: Shqetësim që shpesh e kemi diskutuar, është mungesa e mbi apo nënkalimit te hekurudha që të qon në drejtim të shkollës në Dushkajë. Të bëhet presion edhe në Drejtorinë e Hekurudhave të Kosovës që, ky problem të zgjidhet një herë e përgjithmonë.

Kryetari: Kemi kërkuar nga Drejtoria e Hekurudhave që së paku të vendoset një laurë në kët pjesë , e sa i përket nën dhe mbi kalimit është vështirë të bëhet përshkak të terenit jo të përshtatshëm.

Ramadush Osmani: rrezikshmëria në kët pjesë ka egzistuar edhe në të kaluarën ndërsa tani kjo rrezikshmëri është rritë përshkak të frekuentimit të madh të nxënësve dhe automjeteve. Është mirë që së paku të vendoset një laurë.

Beqir Krasniqi: Pa një bashkpunim të mirë prind-arsimtarë vështirë se do të kemi siguri të mirë për fëmijët . Shumica e prindërve nuk dijnë për sjelljet e fëmijëve të tyre në rrugë dhe në shkollë qka është për të të ardhur keq . Pjesa dërmuese e aksidenteve që ndodhin në trafik nga të rinjët është si pasojë e përdorimit të lëndëve narkotike .

4. Menaxhimi i mbeturinave në Komunën tonë

Rreth kësaj pike Drejtori për Shërbime Publike dhe Emergjenca -**Ramadush Osmani** dha një informatë rreth menagjimit të mbeturinave në komunën tonë ku paraprakisht pjesmarrësit në kët takim u paisën me nga një kopje fizike të këtij informacioni.

Kjani Sallahu: Me planin e punës për kët takim është paraparë që rreth kësaj pike në diskutim të jetë i pranishëm edhe shefi i Njësisë së KRM "Pastërtia"- në Kaçanik, dhe nuk e di a është ftuar apo jo, por gjithsesi kjo temë kërkon t'i ketë prezentë edhe akterët kryesorë, prandaj kërkoj që kjo pikë të shtyhet për takimin e radhës dhe të jenë prezentë edhe ata të "Pastërtisë". Përndryshe, gjendja në terren, sa i përket mbeturinave, nuk është e mirë. Mjetet transportuese të mbeturinave janë nën nivel, ka edhe rrjedhje kundërmuese në rrugë nga kamionë të kompanisë, etj., etj....

Fatmir Qaka: është mirë që kompania „Pastërtia” të njoftojë me kohë qytetarët në rast të ndryshimit të orarit për mbledhjen e mbeturinave ngase kohëve të fundit ky orarë është qrregulluar dhe mbeturinat po mbisin në rrugë kohë të gjatë.

Kryetari: Kjo qështje do të rregullohet dhe për qdo informacion qytetarët do të informohen përmes ëeb. faqës së Komunës dhe rrjeteve sociale.

5. Diskutim rreth ankesave të qytetarëve që ndërlidhen me sigurinë e përgjithshme

- Kjo pikë e rendit të ditës, në mungesë të zyrtarit komunal në lidhje me shqyrtimin e ankesave të qytetarëve, u vendos që të bisedohet në takimin e radhës.

6. Të ndryshme

Rreth pikës së fundit të rendit të ditës, **Kjani Sallahu**, shprehu indinjatën e tij ndaj dy delegatëve të Lëvizjes Vetëvendosje në Kuvendit Komunal, me rastin e vlerësimit të punës 6 mujore të KKSBS-së, të cilët kanë ironizuar me punën e KKSBS-së. Sallahu, me këtë rast, ka komentuar për mënyrën e trajtimit nga ata delegatë të raportit të KKSBS-së, duke i cilësuar vlerësimet e tyre si të ulëta e tendencioze, të cilat shpërfaqin inate e urrejtje subjektive politike.

Kjani Sallahu: ... Roli i KKSBS-së nuk është i njejtë me rolin e EULEX-it, ndërsa ka shumë dallim nga misioni i Lëvizjes Vetëvendosje, sepse KKSBS... është konstruktiv në parandalimin dhe trajtimin e problemeve të sigurisë... KKSBS nuk do të merret asnjëher me agjenda personale apo politike të asnjë individi apo ndonjë strukture politike... KKSBS do të jetë çdoherë aty ku janë qytetarët dhe problemet e tyre, për të rekomanduar gjithnjë, sikur deri tani, përmirësimin dhe zgjidhjen e problemeve dhe situatatave që cenojnë sigurinë e qytetarëve, ashtu siç kemi iniciuar dhe kontribuar për realizimin e shumë projekteve të tilla... Ne jemi këtu për këshilla sigurie, jemi edhe për shtensionimin e situatave eventuale politike dhe rrjedhimisht nuk i gëzohemi fatkeqësive të të tjera, por ata (të LVV-së) nuk duhet të sillen sikur për ata nuk di asgjë dhe nuk i sheh as Zoti... Respekt për institucionin e Kuvendit, por ne ende jemi gjallë dhe do t'ia pamundësojmë secilit subjekt privat apo juridik që të na shikojë si objekt eksperimentues e tallës...

REKOMANDIMET:

1. Të pengohen shitësit ambulantë nëpër rrugë
2. Të rregullohen shtretërit e përroskave që paraqesin rrezik për vërvshime
3. Inspektorët sanitari të janë më aktiv në parandalimin e ushqimeve me afat të skaduar
4. Të pengohet prerja e pa kontrolluar e pyjeve
5. Të ndërpriten ndërtimet më afër se 10 metra nga rruga përgjatë askit rrugor Kaçanik-Doganaj
6. Të krijohen hapësira për parkingje sidomos në rrugën „Qamil Ilazi”, Sali bajra e „Idriz Seferi”

7. Të pengohet dukuria e lypësve
8. Të mirren masa rrëth prezencës së kafshëve në rrugë e trotuare
9. Të vazhdohet me projekte rrëth sigurisë së nxënësve nëpër shkolla
10. Të njoftohen qytetarët rrëth ndryshimit të orarit të mbledhjes së mbeturinave

Pas këtyre rekomandimeve Kryetari përmbylli takimin për tu takuar në mbledhjen e radhës

Kaçanik 20.08.2018

Kryesuesi:

Kryetari i Komunës

z.Besim Ilazi



Procesmbajtës:

Fatmir Qaka